



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT  
PRISHTINË

**NJOFTIM**

Për aplikuesit e konkursit të datës 09.07.2015

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) e Komunës së Prishtinës, sot më 31 korrik 2015, ka bërë publikimin e databazës me të dhënat e kandidatëve që kanë aplikuar për punësim në institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar dhe në bazë të kriterëve ka bërë përzgjedhjen e 5 kandidatëve për intervistim, për secilën pozitë, të cilët kanë aplikuar sipas konkursit të datës 09 korrik 2015.

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/2be88d24-9186-4dae-9768-de6ccf9f2f95/Konkurs---Drejtoria-e-Arsimit.aspx>

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/63c8342c-118f-4cd6-ae56-25097e53af42/Anulim-i-pozites-se-konkursit-09-07-2015.aspx>

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/b75d22de-6a54-47e6-8210-61972bc1cbaa/Plotesim-konkurs-i-dates-09-07-2015---Drejtoria-e-.aspx>

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/cb503fff-565e-478b-bca4-636d2f2528f3/Plotesim-konkursi-i-dates-09-07-2015---Drejtoria-e.aspx>

Përzgjedhja është bërë në monitorimin e shoqërisë civile dhe sipas procedurës së përzgjedhjes, kriterëve të paraseleksionimit dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dokumente të cilat tashmë kanë qenë publike për të gjithë kandidatët, edhe në web faqe të komunës.

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Municipality/Departments/Arsimit/Vendimet-e-DKA/2--Vendimi-per-Proceduren-e-Perzgjedhjes-se-Mesimdhenesve.pdf.aspx>

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Municipality/Departments/Arsimit/Vendimet-e-DKA/Vendimi-per-kriteret-e-paraseleksionimit-per-mesimdhenes.pdf.aspx>

Databaza ka të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar në pozitat prej 1-91, për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit). Kandidatëve që nuk kanë sjellur dëshmi për notën mesatare, nuk kanë mundur t'u llogariten pikët, të njëjtët mund të sjellin dëshmitë brenda afati të ankesave.

Në përcaktim të kandidatëve që do të ftohen në intervistë është marrë për bazë legjislacioni në fuqi dhe Udhëzimi Administrativ (UA) 09/2014, (<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/09-2014-ua.pdf>) ku përparësi kanë pasur kandidatët e rangut të parë dhe kandidatët që kanë pasur më shumë vite të studimeve dhe ECTS kredi,.

- Kandidatët e përzgjedhur për intervistim janë kandidatët e parë, rreshtat e të cilëve janë hijezuar me ngjyrë të kuqe.

- Kandidatët që janë të hijezuar me ngjyrë të kaltër janë kandidatë që janë përzgjedhur për t'u intervistuar në ndonjë pozitë tjetër, meqë kanë aplikuar në më shumë se një pozitë, në ndërkohë që mund të ftohet në vetëm një vend/pozitë për intervistim.

Për të ruajtur konfidencialitetin e kandidatëve, në databaza janë vetëm emrat e mbiemrat e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim, ndërsa për kandidatët e tjerë janë vetëm numrat e protokollit, në mënyrë që secili të mund t'i shoh pikët e tij/saj në ndërkohë që të tjerët nuk mund ta dijnë identitetin e tyre.

Intervistat do të fillojnë nga data 17 gusht 2015. Kandidatët e përzgjedhur për intervistim do të kontaktohen nga komisionet përkatëse për t'u informuar me detajet e intervistimit (vendi, dita, data dhe koha e intervistimit).

Gjithsej kanë aplikuar 3452 kandidatë. DKA, e inkurajon secilin aplikues që në rast ankesë të drejtohen në Drejtorinë e Arsimit përkatësisht në zyrën nr. 77, me datë 3 dhe 4 gusht 2015, ku do të bëhet intervenimi i menjëhershëm në përmirësimin e çdo lëshimit eventual. Kushdo që konsideron se është bërë ndonjë gabim ose i është bërë padrejtësi mund të ushtrojë ankesë me shkrim në DKA me datë 3-7 gusht 2015 (vetëm me shkrim – jo takim) dhe DKA-ja do të kthejë përgjigje brenda afatit ligjor.

Sidoqoftë, para se të ushtroni ankesë ju lusim që paraprakisht t'i lexoni me vëmendje këto sqarime dhe të gjitha dokumentet janë të publikuara në Web faqe: (rregullat, kriteret dhe UA-të përkatëse).